

**MBI**  
**AUDITIMIN E BRENDSTEM**  
**USHTRUAR NE KLUBIN E FUTBOLLIT "VLLAZNIA" SH.A**

Njesia e Auditimit te Brendshem - Bashkia Shkoder, bazuar ne nenin 7 te Ligjit nr. 9720 dt 23.04.2007 ndryshuar me nenin 4 te ligjit nr 10.318 date 16.09.2010 "Per Auditimin e Brendshem ne Sektorin publik";kerkeses se Kryetares te Bashkisë, zhvilloi nje mision auditimit te plote lidhur me veprimtarine e Shoqërisë Klubi i Futbollit "Vllaznia" Sh.A për periudhën Gusht 2011- Korrik 2015 dhe nga auditimi i kryer rezultoi:

**I Permbledhje ekzekutive:** Klubi i futbollit Vllaznia sh.a, është transferuar nga institucion në varësi të bashkisë në shoqëri aksionere në muajin Gusht 2011. Nga kryerja e misionit të auditimit, janë konstatuar mangësi në krijimin e shoqërisë, përpilimin e statusit, rregullores, funksionimit, ka mangësi të theksuara në përgatitjen dhe miratimin e politikave tregtare, cfarë ka sjellë dhe problematika të vazhdueshme ne realizimin e buxhetit të bashkisë. Ka mangësi te theksuara ne menaxhimin financiare dhe kontrollin e aktivitetit, këshillat mbikqyres në vite nuk kanë përmbushur detyrat e tyre që ju ngarkon ligji ne mbikëqyrjen e aktivitetit te shoqërisë. Jane lidhur kontrata në kundërshtim me dispozitat ligjore, janë kryer pagesa në kundërshtim me ligjin dhe interesat e shoqërisë, nuk është zbatuar ligji i prokurimeve publike, ka mangësi të theksuara ne evidentimin e detyrimeve kreditore në pasqyrat financiare nuk i është shtuar kapitalit të shoqërisë logoja e klubit te futbollit per vlere 69.300.000 lek. Ka shkelje te disiplinës financiare me dem efektiv. Për vitet 2011-2015, nuk janë dorëzuar dokumentet e punës nga paraardhësit.

**II. GJETJET.**

**Gjetja nr. 01:** Për transferimin e klubit në Sh.A nga ana e komisionit të ngarkuar, dhe ekspertja kontabel, nuk kanë vlerësuar gjendjen në momentin e transferimit të klubit, nuk është përpiluar bilanci kontabel per periudhen e veprimtarisë 8/mujore, nuk janë evidentuar pasuritë e klubit të cilat duhej ti kalonin Bashkisë, nuk janë pasqyruar gjendjet debitore dhe kreditore si dhe nuk është bërë dorëzimi i dokumentacionit të klubit pranë arkivit të Bashkisë.

**Rekomandim nr. 01** Ngritjen e nje grupi pune për të rivlersuar dhe arkivuar dokumentacionin e ish – klubit të futbollit "Vllaznia"

**Gjetje nr. 02** Është vepruar në kundërshtim me kreu III i Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqërite tregtare" i ndryshuar, nenet 9.10 të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar.

**Rekomandim nr. 02:** regjistrimi i vlerës prej 63.9000.000 lek të logos së Klubit Futbollit "Vllaznia" si kapital i shoqërisë, bazuar në V.K.B nr.69 datë 28.12.2011.

**Gjetje nr 03:** Është vepruar në kundërshtim me pikën "c" neni 135 i ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqërite tregtare" i ndryshuar, për zgjedhjen e organeve drejtuese, këshilli mbikqyrës dhe administrator: Është vepruar në kundërshtim me germen "c", pika II, neni 8 Ligji nr. 8652 date 31.07.2000. "Për organizimin e funksionimin e qeverisjes vendore" në dhënien e kompetencës si ortak i vetem i shoqërisë për ish-Kryetarin e Bashkisë: Është vepruar në kundërshtim me pikat 3 të neneve 13 dhe 167 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqërite tregtare" i ndryshuar, në zgjedhjen e këshillit mbikqyrës, pasi anëtarët e zgjedhur kanë patur detyra funksionale dhe vendimmarrëse që kanë lidhje me veprimtarinë e shoqërisë.

**Gjetje nr. 04:** ka mangësi në përpilimin e statutit të shoqërisë, duke vepruar në kundërshtim me V.K.M nr. 271 datë 09.05.1998 "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore". Është vepruar në kundërshtim me pikën "c" neni 135 i ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqëritë tregtare" i ndryshuar, duke sanksionuar në statut emrat e këshillit mbikqyrës dhe të administratorit.

**Rekomandimi nr. 03:** Ngritjen e një grupi pune me specialist, jurist dhe teknik futbollit për të bërë përmirësimet në statutin e shoqërisë, si dhe për të përpiluar rregulloren e funksionimit për këshillin mbikqyrës dhe administratorin. Më pas statuti dhe rregullorja të miratohen nga Këshilli Bashkiak (Asambleja).

**Gjetje nr 05:** Shoqëria Klubi Futbollit “Vllaznia” Sh.a nuk ka vendosur sistem të kontrollit të brendshëm, nuk ka përcaktuar objektivat, ka konflikt në vendimmarrje, nuk ka kontroll të operacioneve, këto veprime janë në kundërshtim me nenet 11.20.22 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”, nenit 167 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët e shoqërite tregtare” i ndryshuar.

**Rekomandim nr. 06:** Përshtatjen e rregullores së brendshme në përputhje me ligjin nr. 10296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiare dhe kontrollin”, detajimin në mënyrë analitike të organizimit të burimeve në dispozicion, caktimi i përgjegjësive, ndarja e detyrave, përcaktimi i pavarësisë, mënyra e llogaridhënies të të gjithë aktivitetëve që kryen çdo punonjës, detajimin e sistemit të kontrollit sipas aktivitetëve, miratimin e rregullores nga Këshilli mbikqyrës (sipas modelit rastit studimor nr. 03 të manualit të menaxhimit financiarë dhe kontrollit si dhe rregullores së FSHF-së).

**Gjetje nr. 07:** Nuk është përpiluar regjistri i rrishtit, bazuar në objektivat e shoqërisë, duke vepruar në kundërshtim me nenet 11.20.21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin.”

**Rekomandim nr. 07:** Të hartohet regjistri i rrishtit (sipas modelit të rastit studimor nr. 03 të manualit të menaxhimit financiarë dhe kontrollit).

**Gjetje nr. 08:** Janë kryer transaksione financiare pa u bazuar në dokumente ligjore. Ish administratorët dhe Administratori në pozicionin e nëpunësit autorizues, ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”. Ish-financierja dhe financieri në pozicionin e nëpunësit zbatues ka vepruar në kundërshtim me nenet 12.14.17 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”. Nuk janë ndjekur në kohë me evidenca përkatëse zbatimi i buxhetit dhe detyrimet kontraktuale.

**Rekomandim nr. 08:** Të përcaktohen qartë procedura ligjore për kryerjen e transaksioneve financiare, si dhe të ndiqen në mënyrë analitike, zbatimi i buxhetit dhe zbatimi i kontratave me të tretët.

**Gjetje nr. 09:** Nuk ka transparencë në procedurat e ndjekura për arkëtimin e biletave, mungon kontrolli i letrave me vlerë (bileta) ka mangësi në procedurat e ndjekura për përfitimin e reklamave nga të tretët si dhe në lidhjen e kontratave për përfitimin e reklamave nga të tretët për përdorimin e ambienteve të Stadiumit, nuk ka transparencë në përfitimin e të drejtës televizive, shpenzimet e Klubit janë rritur ndërsa rezultatet kanë qënë në rënie.

**Rekomandim nr. 09:** Reklama në stadium është pronë e përbashkët e Bashkisë Shkodër dhe klubit të Futbollit. Procedura për përfitimin e reklamave duhet të organizohet nga administrata e Bashkisë Shkodër me ankand, ndërsa përfitimet duhet të përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Bashkisë dhe klubit futbollit.

**Rekomandim nr. 10:** Për të gjitha ndeshjet që do të zhvillohen në Stadiumin e Shkodrës, biletat të nënshtrohen kontrollit të letrave me vlerë (furnizim, magazinë, përdorues), kontrolli i biletave të organizohet me procedurë prokurimi sipas kërkesave të ligjit të Prokurimeve Publike me dispozitat nenligjore në mbështetje të këtij ligji.

**Rekomandim nr. 11.** Të kërkohet me shkrim pranë Federatës shqiptare të futbollit për të saktësuar të drejtat televizive të përfituara nga viti 2011 deri në vitin 2015, si dhe të saktësohet vlera e arketuar në muajin Janar 2014 për 7.000.000 lek.

**Gjetje nr. 10:** Në Klubin e futbollit “Vllaznia” nuk është ngritur sistemi i monitorimit, duke vepruar në kundërshtim me nenet 23 e 24 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”

**Rekomandim nr.12:** Ngritjen dhe funksionimin e sistemit te informimit dhe monitorimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efencës klubit.

**Gjetje nr. 11:** Nuk është miratuar struktura dhe niveli i pagave për personelin teknik dhe administrativ, duke vepruar në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 10405 datë 24.03.2011 “Për kompetencat percaktimin e pagave e shpërblimeve, është ngritur struktura e akademisë futbollit pa miratim të organeve drejtuese, nuk janë kryer procedura të rekrutimit ne punë, nuk ka rregullore te funksionimit te administratës,nuk është bërë vlerësim i punës kryer,për punonjësit,nuk janë përpiluar dhe mbajtur dosjet personale te punonjësve.

**Rekomandim nr. 13:** Hartimin e rregullores se brendshme të personelit tekniko-administrativ, përcaktimi i kriterëve te marrjes në punë, përcaktimi i procedurave të rekrutimit në punë, vlersimi i punonjësve për rezultatet e arritura të paktën një herë në vit, krijimin dhe mbajtjen e dosjeve të personelit tekniko-administrativ.

**Rekomandimi nr. 13:** Për të gjithë punonjësit e Shoqërisë Klubi i Futbollit Vllaznia, përfshirë punonjësit me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, bazuar ne natyren, rëndësinë, vështërsinë e punës të hartohet struktura dhe masa e pagave e shpërblimeve, dhe më pas të kalojë pranë asamblesë (Këshilli Bashkiak) për miratim.

**Gjetje nr. 12:** Nuk është hartuar, dërguar për miratim buxheti vjetor i shoqërisë, duke vepruar në kundërshtim me germen “a”,pika 2, neni 135 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët e shoqërite tregtare” i ndryshuar,si dhe Rregullores se veprimtarive sportive te Federates Futbollit.

**Rekomandimi nr.14:** Brenda muajit Dhjetor, te bëhet planifikimi i projekt - buxhetit për vitin 2016 sipas përcaktimeve te planifikimit buxhetor ne institucionet buxhetore,bazuar ne treguesit ekonomiko-financiar të shoqërisë klubit futbollit Vllaznia,si dhe të përfshihen të gjitha detyrimet e pa shlyera që janë në proces gjyqësor apo natyra të tjera detyrimesh që kanë bazueshmeri ligjore të krijimit të tyre (në detyrimet e prapambetura të përfshihen vetëm kontraktimet që janë kryer nga përfaqesuesit ligjor të klubit futbollit Vllaznia).

**Rekomandimi nr.15:** Projekt buxheti i hartuar të kalojë për miratim pranë Asamblese së Përgjithshme.

**Gjetje nr.13:** Nuk është bërë programimi i të ardhurave sipas llojit të tyre,nuk është mbajtur evidencë për realizimin e të ardhurave,si dhe nuk është bërë analizë për nxjerrjen e përgjegjësisë për mos arkëtimin e të ardhurave. Nuk është bërë kontabilizimi i të ardhurave.

**Rekomandimi nr.16:** Brenda muajit Dhjetor 2015 te bëhet programimi i të ardhurave sipas arkëtimeve të pritshme dhe ky programim te jetë pjesë e buxhetit që do miratohet nga Asambleja. Për periudhën ne vazhdim të mbahet regjistër i vecantë për detyrimin e të treteve ndaj Klubit, si edhe në fund të cdo viti financiar të behet analizë e plotë e realizimit të të ardhurave, si dhe te bëhet kontabilizimi i të ardhurave ne fakt dhe të ardhurat sipas detyrimeve.

**Gjetja nr.14:** Nga ish/administratorët dhe administratori kanë vepruar me initiative personale ne caktimin e pagave duke vepruar në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 10405 datë 24.03.2011 “Për kompetencat percaktimin e pagave e shpërblimeve”.

Për sezonet 2012-13, 2013-14, 2014-15, janë kontraktuar persona me shtetësi te huaj,të cilët nuk janë pajisur me leje qëndrimi dhe leje pune duke vepruar në kundërshtim me nenin 22,41,28 te ligjit nr.9959 datë 17.17.2008 “Për te huajt”. Është vepruar ne kundërshtim me pikën 1 të VKM nr 1114 datë 30.07.2008 i ndryshuar” Për disa çeshtje ne zbatim te ligjeve 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore ‘i ndryshuar,ligjit nr 9136 datë 11.09.2003,i ndryshuar “Për mbledhjen e kontributeve te detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shendetesore”. Nuk është përpiluar libri i pagave, veprim që bie ne kundërshtim me pikën 2 te V.k.M nr. 594 date 22.12.1997 “Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësin e tij”

**Rekomandimi nr.17:** Për të gjithë personelin e shoqërisë të Klubit të futbollit Vllaznia përfshirë punonjes shërbimi, specialist futbollit, lojtarë, trajner, staf mjeksorë, punonjës

administratë, drejtues të niveleve të ndryshme të trajtohen sipas pikës 1 të VKM nr.1114 datë 30.07.2008, i ndryshuar "Për disa ceshtje ne zbatim te ligjeve 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore "i ndryshuar, ligjit nr 9136 datë 11.09.2003, i ndryshuar "Për mbledhjen e kontributeve te detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shendetesore".

**Rekomandimi nr.18:** Të plotësohen dosjet personale për të gjithë punonjësit e shqërisë Klubi i futbollit "Vllaznia"

**Rekomandimi nr.19:** Për të gjithë punonjësit me shtetsi te huaj të zbatohen nenet 22,41,28 te ligjit nr.9959 datë 17.17.2008 "Për te huaj"

**Rekomandim nr. 20:** Te plotesohet libri i pagave per punonjesit sipas formatit, pika 2 e V.k.M nr. 594 date 22.12.1997 "Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësin e tij"

**Gjetje nr.15:** Janë lidhur kontrata me te trete per pjesëmarrje dhe administrim të shoqërisë, duke vepruar në kundërshtim me neni 135 i ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqëritë tregtare" i ndryshuar, pasi personat qe kanë lidhur kontrate nuk kanë pjesë të aksioneve të shoqërisë.

**Rekomandim nr.21:** Te behet një vlerësim paraprak i dëmeve të shkaktuara nga lidhja e kontratave me të trete për administrimin e klubit dhe me tej, të kerkohet në rrugë gjyqësore zhdemtimi i demit të shkaktuar.

**Gjetje nr. 16:** Jane konstauar shkelje te disiplines financiare me dem efektiv per kontrata sherbimi te futbollisteve, shperblime shpenzime personale, trajtime ushqimore, shpenzime spitalore.

**Gjetje nr. 17:** Janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dem efektiv per shpenzime transport tifoze, karburnat.

**Gjetje nr. 18:** Është vepruar në kundërshtim me pikën 9, neni 13, piken 1 neni 15 të rregullores veprimtarive sportive, nenin 59 te ligjit nr.9920 datë 15.09.2008 "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", "d" neni 135,151, 163,167 i ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët e shoqëritë tregtare" i ndryshuar, germa "ç"pika 4 neni 3 e ligjit 9643 datë 20.11.2006" Për prokurimet publike",i ndryshuar VKM nr 124 datë 04.04.2002"Për trajtimin e sportisteve te nivelit të lartë"

**Rekomandim nr. 22:** Përzgjedhja e futbollisteve te bëhet me bord te vecante vlerësimi, në përberje te bordit të kete vlersues të cilësisë sportive sipas disiplinave që ka sporti i futbollit, bazuar ne kriteret e perpiluara percaktuara nga bordi dhe te miratuara nga këshilli mbikqyrës.

**Rekomandim nr. 23:** Për të gjithë sportistet e nivelit të lartë (formacioni baze) të lidhet kontratë pune(në prani të noterit), me te drejta e detyrime, vlera e kontratave te jete pjese perberse e buxhetit te miratuar nga asambleja.

**Rekomandim nr. 24:** Për kontratat e shërbimit futbollistik, të zbatohet ligji nr. 9643 datë 20.11.2006" Për prokurimet publike",i ndryshuar e dispozitat e tjera ligjore në mbështetje të këtij ligji.

**Rekomandim nr. 25:** Nese ka kontraktime me lojtar të huaj të percaktohet në kontratë kushti që të jenë të pajisur me leje pune dhe leje qëndrimi.

**Rekomandim nr. 26:** Trajtimi ushqimor te behet, deri ne 25 futbolliste te federuar, dhenia e trajtimit ushqimor te percaktohet me vendim të këshillit mbikqyrës.

**Rekomandim nr. 27:** Në referencë te neneve 151,163,167 te ligjit 9901 "Për shoqëritë tregtare" për dëmin e shkaktuar shoqërisë Asambleja e Përgjithshme ti kërkojë gjykatës zhdëmtim dëmi, nga ish- administratorët, administratori, ish- keshilli mbikqyrës dhe keshilli mbikqyrës per vleren e përcaktuar në gjetjen nr. 16.

Është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 date 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, V.K.M nr. 01 date 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, është vepruar në kundërshtim me kreun V, nenin 59 te ligjit nr.9920 datë 15.09.2008 "Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë".Nuk është mbajtur dokumentacioni i arkes, perfshire librin e arkes, mandat-pagesa mandat arketime dokumentat

justifikues ligjore etj. Këto veprime bien në kudnërshtim me nenin 3 të ligjitnr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare i ndryshuar.

**Rekomandim nr. 28:** Në referencë të neneve 151,163,167 të ligjit 9901”Për shoqëritë tregtare” për dëmin e shkaktuar shoqërisë Asambleja e Përgjithshme të kërkojë gjykatës zhdëmtim dëmi, nga ish- administratorët, administratori, ish- këshilli mbikqyrës dhe këshilli mbikqyrës për vlerën e përcaktuar në gjetjet nr. 16.17.

**Rekomandim nr. 29:** Te ngrihet njesia e perhershme e prokurimit, te trajnohet kjo strukture dhe per te gjitha shpenzimet me vlere te ulte dhe te larte të kryhen procedurat e prokurimeve publike, parashikuar nga Ligji nr. 9643 date 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, V.K.M nr. 01 date 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Rekomandojme që të zbatohet udhezimi nr.02 date 06.02.2012 “Për procedurat standarte të buxhetit”.

**Rekomandim nr.30:** Për të gjitha kontratat e lidhura nga persona të cilet nuk kanë qënë administrator të shoqërisë dhe ka patur efekte financiare në kundërshtim me interesat e shoqërisë, të ngrihet padi civile pranë gjykatës administrative për zhdëmtim dëmi.

**Rekomandim nr.31:** Brenda muajit dhjetor 2015 të bëhet sistemimi i të gjithë dokumentacionit arkës, përfshirë mandat arkitime, mandat pagesa, libri i arkës dokumentet ligjore

**Gjetje nr.18:** Nuk janë kryer regjistrimet kontabile, nuk është hartuar regjistri dhe rregullorja e aseteve, nuk janë evidentuar detyrimet kreditore, janë pasqyruar të ardhura pa u bazuar në dokumente ligjore, nuk është bërë regjistrimi i kapitalit për vlerën e logos:

**Rekomandim nr. 32:** Brenda muajit Dhjetor 2015 të bëhet printimi i të gjithë regjistrimeve kontabile dhe të nënshkruhet nga financierët përkatës. Të evidentohen të gjitha detyrimet kreditore ndër vite dhe të regjistrohen në pasqyrat financiare të vitit 2015.

**Rekomandim nr. 33:** Bazuar në nenin 14 të ligjit 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, germa, neni 8 i ligjit nr. 112/2015 “Për Inspektimin Financiare Publik”, të fillojë procedura për kryerjen e inspektimit Financiare për shoqërinë Klubi i Futbollit “Vllaznia” Sh.a, me kapital 100% Bashkia Shkoder, sipas konstatimit të gjetjeve 16 e 17.

**NJESIA E AUDITIMIT BRENDSHEM  
BASHKIA SHKODER**